

VENDIM
Nr. 310, datë 22.5.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË PAGESËS PËR ANËTARËT E KOMISIONIT
TË LICENCAVE, PËR KULTIVIMIN E *CANNABIS*-it PËR QËLLIME
MJEKËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët e emëruar në Komisionin e Licencave për kultivimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore përfitojnë një pagesë për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në këtë komision, në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë për mbledhje, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) pagesa në vit.
2. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga momenti i bërjes efektive të komisionit dhe këto efekte përballohen brenda buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
3. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama